

L I G J
Nr.8487, datë 13.5.1999

PËR KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E PAGAVE TË PUNËS

(Ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Paga përfaqëson të ardhurat në para që punëdhënësi i jep punëmarrësit për punën e kryer në sasi, cilësi dhe kohë. Paga përcaktohet në kontratën e punës, e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Neni 2

Në Republikën e Shqipërisë për caktimin e pagës, sipas përkatësisë, kanë kompetencë:

- Kuvendi;
- Këshilli i Ministrave;
- ministritë dhe institucionet e tjera qendrore dhe organet e pushtetit vendor;
- ndërmarrjet shtetërore;
- personat e tjerë juridikë a fizikë, vendas ose të huaj.

Neni 3

Në nenin 2 të këtij ligji me “ndërmarrje shtetërore” nënkuptohen ndërmarrjet me kapital 100 për qind shtetëror, që funksionojnë në mbështetje të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, ndërmarrjet që funksionojnë në mbështetje të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, si dhe institucionet shtetërore jobuxhetore, bankat, INSIG-u dhe institucione të tjera me kapital tërësisht shtetëror, sipas përcaktimit që do të bëjë Këshilli i Ministrave.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002)

Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, miraton:
pagën e Presidentit;

b) raportet e pagave të funksionarëve të lartë shtetërorë, të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj;

c) shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të institucioneve qendrore të pavarura.

Neni 5

(Ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002)

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, miraton:

- a) pagën minimale mujore në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj;
- b) pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas raporteve të pagave të përcaktuara nga Kuvendi, pagat e titullarëve të institucioneve të tjera qendrore që nuk përfshihen në nenin 4 dhe pagat e personave të tjerë të barazuar me ta, sipas nenit 4;
- c) aktet nënligjore për funksionimin e strukturës së pagave dhe të shpërblimit për nëpunësit civilë;
- ç) kriteret dhe masën e shpërblimeve shtesë, për punën jashtë orarit, për nëpunësit civilë;
- d) klasifikimin dhe nivelet e ndryshme brenda secilës klasë të nëpunësve civilë të përkatësisë së tij;
- dh) klasifikimin dhe vlerësimin e vendeve të punës për shërbimin civil;
- e) strukturën e pagave për punonjësit e administratës publike qendrore;
- ë) klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe kufijtë maksimalë e minimalë të pagave për funksionarët e zgjedhur, të emëruar, për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë në organet e qeverisjes vendore;
- f) numrin e klasave, kufijtë e masës së pagës dhe të shtesave mbi pagë sipas klasave, për punonjësit e administratës publike, që nuk përfshihen në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil";
- g) shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, që nuk janë miratuar me akte të tjera ligjore, me kusht që asnjë person të mos marrë pjesë në më shumë se dy këshilla, dy borde ose dy komisione;
- gj) kompetencat në fushën e pagave të organeve të larta shtetërore, ministrive e institucioneve të tjera qendrore, si dhe kufirin maksimal të pagave të drejtuesve të ndërmarrjeve publike me kapital tërësisht shtetëror;
- h) masën e indeksimit të pagave, sipas ndryshimit të pritshëm të indeksit të çmimeve të konsumit në fillim të çdo viti dhe rregullat për zbatimin e saj.

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002)

Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli komunal, sipas përkatësisë, miratojnë:

- a) pagën për çdo funksion të zgjedhur, të emëruar, për nëpunësit civilë dhe për punonjësit e tjerë, brenda kufijve të pagave për çdo grup të njësive të qeverisjes vendore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave;
- b) njehsimin në pagë, në përputhje me klasifikimin e funksioneve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, për çdo funksion të ri që vendos të krijojë;
- c) shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit të qarkut, të kryetarit të bashkisë dhe të kryetarit të komunës;
- ç) shpërblime të personave, nga burimet e veta financiare, të cilët caktohen në komitete, borde, këshilla, komisione e të tjera të kësaj natyre, që ngrihen me vendim të këshillit përkatës;
- d) pagat e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë së tij, duke respektuar legjislacionin në fuqi, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë

është parashikuar ndryshe.

Neni 7

Ndërmarrjet shtetërore i caktojnë vetë pagat e punës, në varësi të mundësive të tyre financiare, sipas programit të zhvillimit të miratuar nga organet përkatëse.

Neni 8

Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje dhe subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave cakton rregulla të veçanta për kufizimin e pagave.

Neni 9

Ligji nr.7583, datë 13.7.1992 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës" shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2374, datë 20.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani